6. perform the registrations and deliver the obligatory data of the Company to the national registration center, as required by law;
7. report before the General Assembly in relation with the implementation of commercial policies and the realization of particular actions of special importance for the activity of the Company;
8. perform other duties provided by the Law and Articles of Association.

If the General Assembly appoints more than one Administrator, they administer the Company jointly. The Articles of Association or other regulations, approved by the General Assembly, may provide differently. The General Assembly may dismiss the Administrator at any time by a simple majority of votes. The Articles of Association or other agreements cannot exclude or restrict this right. Proceedings, related to the rewards of the Administrator/s, based on contractual relations with the Company, are regulated according to the provisions in force. The Administrator/s has/have limits to his/her powers. He/She has no right to conclude contracts with an amount higher than the equivalent of Euro 40.000 in ALL (lek) without the approval of the second signature that is hold by Mr. Charalampos Alexandros Spiliopoulos, Greek citizen, born on 14 March 1973 in Munich, of legal age and capacity to act, bearer of the passport no AY3290971. The second signature is appointed by an unanimous decision of the General Assembly.

ARTICLE 31

Rewards of the Administrators

The normal reward of the Administrator/s can obtain additions, for example performance-based components. The rewards of the Administrator/s can be defined by a ordinary decision with simple majority and a quorum of 50% of the General Assembly. The reward must be in compliance with the duties of the Administrator/s and the financial situation of the Company. If the Company is in financial difficulty, the General Assembly must decide on the reduction of the rewards of the Administrator/s in an appropriate size. The criteria of rewarding, individual rewarding and the yearly effect of rewards of the Administrator/s



in the structure of the costs of the Company are published together with the yearly financial statements.

ARTICLE 32

Certified auditors

The Company appoints certified auditors for every financial year. Their appointment is made by the General Assembly Meeting. The certified auditors hold responsibility for the correct keeping of all the documentation of the Company. They are responsible for the damages to the Company and the incorrect keeping of the accounts or their wrong verification. There is a conflict of interest and they cannot be charged with the task of the certified auditors if they are Shareholders, Administrator/s, persons who are relatives of the Shareholders or Administrator/s, in-laws up to the fourth level is elected.

VI. JOB RELATIONS

ARTICLE 33

Job relation in the Company is regulated according to the provisions of the Articles of Association and the Albanian labor legislation. Employment by the Company is performed through the labor individual contract between the Company and the employees. The relations between the Company and the trade union are regulated by the collective labor contract.

ARTICLE 34

The employees, governing officers and administrative employees are responsible for the damages caused to the Company due to their fault and they are accountable for it civilly.

VI. DISSOLUTION OF THE COMPANY & LIQUIDATION

ARTICLE 35

This Company will dissolve in case:

1. of expiry of the period for which it was established;
2. of a decision by the General Assembly;
3. of opening of bankruptcy procedures;
4. if it has not performed commercial activity for two years and has not reported the suspension of activity in compliance with section 3 of article 43 of law nr.9723, as of 3.5.2007 "For National Registration Centre";
5. of a decision of the court;
6. of other reasons foreseen in the Articles of Association;

Dissolution of the Company is registered in the commercial register by the national registration center upon respective report of the Administrator/s. In case of dissolution by



court decision, the court shall transmit the decision to the national registration center for registration in accordance with Art. 45 of Law No. 9723 on the national registration center.

ARTICLE 36

Liquidation of the Company

The dissolution of the Company has as a consequence the opening of liquidation procedures in the situation of paying capacity, except for the cases when a bankruptcy procedure has commenced. In case of limited liability companies, the liquidation takes place by the liquidator/s appointed by the General Assembly. If the General Assembly does not take a decision on the appointment of the liquidator/s, within 30 days from the dissolution, every person concerned may request the court, to appoint a liquidator. Every person concerned, has the right to request the court to replace the liquidator, appointed by the decision of the Shareholders, if they represent considerable reason to doubt that the regular liquidation of the Company may be threatened by the appointed liquidator. The request must be deposited with the court within 30 days of the date the liquidator is assigned. The court appoints the liquidator, in cases the Company is dissolved by a court decision. The liquidator/s is/are dismissed and replaced based on the same conditions foreseen in the provisions of its/their appointment. The Administrator/s of the Company announce/s for registration, national registration center, the data of the first liquidator/s and its/their rights, to represent the Company, together with the respective documents. The liquidator/s deposit/s its/their signature. The liquidators also announce by the national registration center every change of identity and rights of representation. The appointment of the liquidator by the court is registered *ex officio*, according to the article 45 of law nr. 9723, as of 3.5.2007 "For the National Registration Centre". With the opening of liquidation procedures, the registered name of the Company is followed by the note "under liquidation". The liquidator/s must invite the creditors of the Company to file their claims with respect to the dissolution of the Company. The liquidator takes over the rights and obligations of the Administrator/s from the date of his/her appointment.

ARTICLE 37

The rights and obligations of the liquidator

The task of the liquidator is the closing of all the activities of the Company, collection of all the unpaid loans and unpaid contributions, the selling of the assets of the Company and payment of the creditors respecting the reference turn, according to the article 605 of the Civil Code. The liquidator may perform other new commercial activities to close an unfinished activity. If, based on the proceedings of the creditors, the liquidator/s notice that the assets of the commercial activity, including the unpaid contributions, is not enough for the payment of these pretensions, the liquidator/s is/are obliged to suspend the procedure of liquidation and ask the court the commence of bankruptcy procedures.

ARTICLE 38

Balance sheets of liquidation



The liquidator prepares a balance sheet of the situation of the Company at the moment of the start of liquidation and a final balance sheet at the moment of closure of these procedures. If the liquidation procedure lasts for more than a year, the liquidator prepares, also, the yearly financial statement of the Company at the end of the business year after the commencement of the liquidation. The financial statements are approved by the General Assembly.

ARTICLE 39

Distribution of assets

After the payment of the obligations to the creditors, the liquidator distributes to the Shareholders the remaining assets, according to the rights they have in the distribution of the profits, excluding the cases when preferences are granted by the Articles of Association. Property lent or used by the Company shall be returned to the Shareholders concerned. Once the remaining assets have been distributed, the liquidator shall announce the end of the liquidation to the national registration center and request the deregistration of the Company in accordance with Section V of Law No. 9723 on the national registration center.

ARTICLE 40

Simplified liquidation

The Company may be liquidated through an accelerated procedure, if this is decided by the Shareholders and when they declare before the respective court that all the obligations to the creditors have been paid and all the relations with the employees have been regulated. The Administrator/s, in concordance with article 43 of law nr.9723, as of 3.5.2007 "For the National Registration Centre", announce/s for registration by the national registration center the decision for the liquidation of the Company through a simplified procedure. The Administrator/s is/are responsible for the damage caused by the breach of his/her duties during the simplified procedure. Besides the Administrator/s, the Shareholders shall be jointly and severally liable up to the amounts of the compensation recovered.

VII. FINAL PROVISIONS

ARTICLE 41

These Articles of Association come into force after approval and registration of the Company in the commercial register by the national registration center.

ARTICLE 42

Everything that is not expressly provided in these Articles of Association shall be subject to commercial legislation and other laws related to it in force in the Albanian Republic.



ARTICLE 43

These Articles of Association were read and mutually established by the founding Shareholders and were found without any objections. The Articles of Association were prepared in three copies in English language and translated in Albanian language from translator Mrs. Eva Xhani accepted from the Shareholders of the Company.

FOUNDING SHAREHOLDERS

**For and on behalf of the Shareholder Albanian Development Company ADC
SH.P.K**




Name: Eneid Lika
Position: Administrator

For and on behalf of the Shareholder TÜV AUSTRIA HOLDING AG:



Name: DI Dr. Stefan Haas
Position: CEO



Name: Mag. Christoph Wenninger
Position: CFO

Annex 1:

KONTRATE SHIT - BLERJE KUOTASH
("Kontrata")

Sot më datë __ / __ / __, lidhet kjo kontratë ndërmjet palëve me kushtet dhe termat e mëposhtme:

SHITËSI:

"Albanian Development Company ADC SH.P.K", regjistruar dhe që zhvillon veprimtarinë sipas ligjeve shqiptare në fuqi, me seli të regjistruar në Rr. "Rezervat e Shtetit", Lunder 1, Zona Kadastrale Nr. 2529, Pasuria nr. 590/1/4, Volume 6, Faqja 106, Lunder, Farkë, Tiranë, Shqipëri, identifikuar me nr. NIPT L52104227K, e përfaqësuar në nënshkrimin e kësaj kontrate nga administratori i saj

DHE

BLERESI

- **TÜV AUSTRIA HOLDING AG**, person juridik austriak që vepron sipas ligjeve të Austrisë, me seli të regjistruar në zyrat e Deutschstraße 10, 1230 Vienna, Austria, regjistruar në Rregjistrin Tregtar me nr. FN 286107x, përfaqësuar nga administrator dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë

Shitësi dhe blerësi do t'ju referohemi kur janë sëbashku me termin "**Palët**" dhe individualisht si "**Palë**".

Palët kanë rënë dakord për lidhjen e kësaj kontrate për shit-blerjen e kuotës, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME:

SHARE TRANSFER AGREEMENT
(the "Contract")

Today, on __ / __ / __, between the Parties, with the following terms and conditions:

THE SELLER:

"Albanian Development Company ADC SH.P.K", duly established and operating under the laws of Albania, with registered offices in Strët "Rezervat e Shtetit", Lunder 1, Cadastral Zone Nr. 2529, Property nr. 590/1/4, Volume 6, Page 106, Lunder, Farke, Tirana, Albania with unique identification number of the subject L52104227K, duly represented at the signing of this agreement by its administrator (hereinafter referred to the "**Seller**")

AND

THE BUYER:

- **TÜV AUSTRIA HOLDING AG**, an Austrian legal entity duly established and operating under the laws of Austria, with registered offices in Deutschstraße 10, 1230 Vienna, Austria, registered with the commercial registry under number FN 286107x, duly represented by its legal representative (hereinafter referred to the "**Buyer**")

the Seller and the Buyer collectively referred to as the "**Parties**" and individually the "**Party**".

The Parties have agreed to conclude this Contract for share transfer, under the laws of Albania.

GENERAL PROVISIONS:



Shitësi në këtë kontratë është ortak i TUV AUSTRIA Albania SH.P.K. (këtu e më poshtë do të përmendet me emrin “Shoqëria”), një shoqëri e krijuar sipas ligjeve shqiptare, rregjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Shitësi është posedues i një kuote të kapitalit të Shoqërisë TUV Albania, sipas përqindjes së reflektuar në ekstratin e shoqërisë.

Blerësi, ortak në shoqëri, nëpërmjet kësaj kontrate dëshiron të blejë kuotën e shitësit me qëllim që të bëhet pronar në masën prej ____ të kapitalit të Shoqërisë me të gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia e kuotës.

Neni 1 OBJEKTI I KONTRATES

Objekti i kësaj kontrate është transferimi nga shitësi tek blerësi i kuotës së zotëruar në shoqëri.

NENI 2 ÇMIMI I TRANSFERIMIT TË KUOTAVE DHE PAGESA

Blerësi në mënyrë të parevokueshme bie dakord dhe deklaron të kryejnë pagesën sipas pikës 2 të këtij neni, e cila përfaqëson çmimin e transferimit të masës prej ____ % të kapitalit të shoqërisë të përbërë nga një kuotë sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

Çmimi i shitblerjes është paguar nga blerësi sipas mandatit bashkëlidhur dhe shitësi nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje me të sot dhe në të ardhmen.

NENI 3

The Seller in this Contract is shareholder of the Company TUV AUSTRIA Albania SH.P.K. (hereinafter referred to as the “Company”), a company duly incorporated under the Albanian laws, registered within the commercial register of the National Center of Registration.

The Seller is the owner and possessor of one share of the capital of the Company, holding the percentage as provided in the extract of the Company.

The Buyer also shareholder of the Company, through this Contract wishes to purchase the Seller's share in order to become the owner of ____% of the capital of the Company with all the rights and obligations stemming from the ownership of the quote.

ARTICLE 1 SUBJECT MATTER OF THE CONTRACT

The object of this Contract is the transfer from the Seller to the Buyer of share owned in the capital of the Company.

ARTICLE 2 THE PRICE OF THE SHARE TRANSFER AND THE PAYMENT

The Buyer hereby and irrevocably agrees and declares to make the payment according point 2 of this article, which represents the transfer price of ____% of the Company's capital consisting of one share as described in this Contract.

The purchase price is paid from the Buyer to the Seller and the Seller shall have no claim today or in the future.

ARTICLE 3



TRANSFERIMI I PRONËSISË

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pagimit të plotë të çmimit në përputhje me nenin 3 të saj, kapitali themeltar i shoqërisë do të zotërohet në masën ____% nga blerësi.

NENI 4 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj kontrate, teksti në gjuhën shqipe do të ketë prioritet.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje identike në shqip dhe anglisht, ku secila nga palët mban një kopje, një kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar, një kopje do të depozitohet në Aktet e Shoqërisë.

Kjo kontratë ju bë e njohur në gjuhën angleze palëve, të cilat e nënshkruan në variantin anglisht prej përkthyeses Znj. Eva Xhani, e njohur personalisht dhe pranuar prej palëve.

PALËT

SHITËSI:

BLERËSI

THE TRANSFER OF THE PROPERTY

After the signing of this Contract, the registered capital of the company shall be owned by ____% of the capital by the Buyer.

ARTICLE 4 FINAL PROVISIONS

This Contract is compiled both in English and Albanian language. In case of controversial interpretation or application, the text in Albanian shall prevail.


This Contract is compiled in 4 (four) identical copies both in English and Albanian, whereof each Party keeps one, one copy will be deposited in the Commercial Register, one copy will be deposited in the Company's Acts.

This Contract was translated in English language for acknowledgement by the Parties from the translator Ms. Eva Xhani personally known and accepted by the Parties in this Contract.

THE PARTIES

THE SELLER:

THE BUYER:



STATUTI I SHOQËRISË
“TÛV AUSTRIA ALBANIA” SH.P.K.
SELIA LIGJORE NË TIRANË, SHQIPËRI

Sot, në datë 4 mars 2025, ortakët themelues:

- Shoqëria shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Albanian Development Company ADC SH.P.K”**, e krijuar rregullisht dhe që vepron sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në rrugën “Rezervat e Shtetit”, Lundër 1, Zona Kadastrale Nr. 2529, Pasuria nr. 590/1/4, Vëllimi 6, Faqe 106, Lundër, Farkë, Tiranë, Shqipëri me numër unik identifikimi të subjektit L52104227K, i përfaqësuar rregullisht sipas vendimit të asamblesë së ortakëve datë 12 shkurt 2025 në nënshkrimin e këtij Statuti nga Administratori i saj, z. Eneid Lika, shtetas shqiptar, lindur në 21 maj 1980, mbajtës i ID me numër personal I00521201V (në vijim referuar si **“Ortaku i pakicës”**)
- **TÛV AUSTRIA HOLDING AG**, një person juridik austriak i krijuar dhe që vepron sipas ligjeve të Austrisë, me seli në Deutschstraße 10, 1230 Vjenë, Austri, i regjistruar në regjistrin tregtar me numrin FN 286107x, i përfaqësuar rregullisht nga Drejtori i saj Ekzekutiv z. DI Dr. Stefan Haas dhe Drejtori i Financës z. Mag. Christoph Wenninger (në vijim referuar, si **“Ortaku i shumicës”**)

(të dyja palët së bashku në vijim referuar si **“Ortakët”** ose **“Ortakët Themelues”** dhe individualisht **“Ortaku”**)

Kanë vendosur të themelojnë shoqërinë **“TÛV AUSTRIA Albania” SH.P.K.** (në vijim referuar si, **“Shoqëria”**) me kushtet dhe termat e mëposhtme:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria **“TÛV AUSTRIA Albania” SH.P.K.** rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e ortakëve, të organeve të saj, llojin e shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë, marrëdhëniet me punëmarrësit, në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 **“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”**, i ndryshuar, dhe dispozita të tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi, që rregullojnë marrëdhëniet e shoqërive tregtare.

NENI 1

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt të aktivitetit të saj: ofrimin e monitorimit, inspektimit, testimit, këshillimit teknik, auditimit, shërbimeve të certifikimit në përgjithësi, kryerjen e të gjitha llojeve të auditimeve teknike, inspektimeve, monitorimit, kërkimit, sondazheve, opinioneve të ekspertëve, shërbimeve këshillimore teknike, konsultime dhe certifikime në lidhje me një sërë objektesh, instalimesh, pajisjesh, veglash, procesesh dhe makinerish, si dhe të gjitha llojet e produkteve për të siguruar cilësinë, funksionimin, fizibilitetin, sigurinë kibernetike, ekonominë dhe sigurinë gjatë ndërtimit, ngritjes, operimit, përdorimit, riparimit, si dhe tërheqjes ose ripërdorimit të tyre. Kryerja e matjeve dhe vlerësimeve për çështjet mjedisore, certifikimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë, produkteve dhe personelit, si dhe funksionimi i bizneseve, ofrimi i informacionit dhe trajnimi në fusha të ndryshme nëpërmjet organizatës trajnuese TÛV

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



AUSTRIA ACADEMY, e cila ofron programe trajnimi në nivel ndërkombëtar. Ofrimi i shërbimeve dixhitale të trajnimit sinkron dhe/ose asinkron duke përfshirë krijimin e përmbajtjes arsimore përmes platformave të specializuara dixhitale dhe aplikacioneve celulare. Ofrimi i shërbimeve si qendër e operacioneve të sigurisë për të adresuar kërcënimet dhe rreziqet kibernetike. Ofrimi i shërbimeve të sigurisë në lidhje me transportin e personave dhe mallrave në përgjithësi (p.sh. të automjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme). Ofrimi i informacionit dhe trajnimit në të gjithë sektorët e sipërpërmendur, si dhe në sektorë të tjerë teknikë dhe shëndetësorë që lidhen me to. Më tej, lëshimi i dokumenteve (raporteve, konstatimeve, certifikatave, vërtetimeve etj.) dhe opinioneve, mendimeve të ekspertëve në lidhje me të gjitha shërbimet e sipërpërmendura dhe ndërmarrja e porosive, si kontraktorë të përgjithshëm (kontraktorë) ose nënkontraktorë, në fushat nga të gjitha përfitimet e sipërpërmendura, si dhe çdo që lidhet me veprimtarinë e mësipërme. Kryerja e inspektimeve dhe certifikimeve në të gjitha llojet e ekonomive bujqësore të bujqësisë konvencionale dhe/ose organike, duke ofruar këshilla teknike për çështje teknike ose të tjera të harmonizimit të legjislacionit bazuar në direktivat, rregulloret, ligjet përkatëse evropiane dhe në përgjithësi kuadrin legjislativ dhe rregullator evropian ose ndonjë kuadri tjetër ligjor dhe/ose rregullator që shteti kompetent shqiptar zgjedh të përfshijë si legjislacion shqiptar ose kuadër rregullator përkatës. Gjithashtu, ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të sistemeve kompjuterike, menaxhimit të rrjeteve dhe sistemeve kompjuterike, shërbimeve të instalimit të pajisjeve kompjuterike dhe periferike, si dhe ofrimi i shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe kompjuterit etj. dhe konvertimi dhe korrigjimi i mediave dixhitale (CD, disqe, etj.). Ofrimi i shërbimeve të përpunimit të të dhënave, zhvillimi dhe ruajtja e bazave të të dhënave, sigurimi i pajisjeve ose rrjeteve të përpunimit të të dhënave dhe përgatitja e futjes së të dhënave, ofrimi i shërbimeve kompjuterike pritës, funksionimi i aplikacioneve dhe ofrimi i infrastrukturës tjetër të teknologjisë së informacionit, si dhe shërbime për prodhimin të përmbajtjes së portaleve të internetit.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj veprimtarie sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 2

Emri dhe selia ligjore e Shoqërisë

Shoqëria është një person juridik privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullim civil me emërtimin e saj "TÜV AUSTRIA Albania" SH.P.K., ose shkurtesën e saj TÜV AUSTRIA Albania SHPK.

Selia ligjore e Shoqërisë është në Republikën e Shqipërisë në adresën: Njësia Administrative.5, Rr.Ibrahim Rugova, Pallati 28, Hyrja 9, Apartamenti 30, Kutia Postare 1019, Tiranë, Shqipëri.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria do të operojë për një afat të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe mund të kufizohet ose zgjatet, një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve me Shumicë të Cilësuar.

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



NENI 4

Regjimi Ligjor i Shoqërisë

Shoqëria drejtohet nga parimet e një ekonomie tregu të hapur dhe ka si qëllim sigurimin e fitimeve. Ai respekton parimin e reciprocitetit. Është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të statutit dhe dispozitave të legjislacionit tregtar dhe civil në fuqi. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të ndryshojë regjimin e saj ligjor me një vendim përkatës të marrë në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e Statutit, duke bërë përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse. Shoqëria është e pajisur me personalitet të plotë juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

NENI 5

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e Shoqërisë deri në vlerën e kontributeve të papaguara. Asetet e krijuara nga Shoqëria gjatë veprimtarisë së saj i përkasin Shoqërisë. Këto (asete) mund të barten, jepen me qira, jepen peng dhe hipotekohen me miratimin e shumicës së kualifikuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

NENI 6

Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve

Ortakët japin kontributet e tyre në shoqëri në para ose në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në këtë statut ose në vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë Ortakët për ecurinë e shoqërisë dhe, me kërkesën e tyre, duhet të vendosin në dispozicion të tyre llogaritë vjetore, duke përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet e situatës dhe raportet e progresit në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë, raportet nga organet drejtuese ose nga ekspertët kontabël të autorizuar, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, përveç rasteve kur ka sekrete tregtare, të cilat konsiderohen nga shoqëria si informacion i brendshëm ose si dokument i mbrojtur nga Shoqëria dhe në rast se ato i dorëzohen personave të paautorizuar do të shkaktonin dëme të konsiderueshme në interesat tregtare të Shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të tërhiqen nga Shoqëria dhe të transferojnë (shesin) pjesëmarrjen e tyre, në përputhje me kushtet e lejuara nga ky Statut dhe ligji. Tërheqja nga Shoqëria nuk i çliron Ortakët nga detyrimet e ndërmarra përpara momentit të tërheqjes dhe nuk kufizon të drejtën e tyre për dividend ose shpërndarje tjetër deri në këtë moment. Ortakët, duke ushtruar të drejtën e tyre, do të veprojnë në mënyrën e duhur dhe duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë të drejtat dhe detyrimet sipas statutit dhe strukturës ortakëve të paraqitur në nenin 13. Ortakët respektojnë detyrimet që rrjedhin nga statuti. Ortakët përpiqen

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



të fillojnë veprimtarinë e Shoqërisë sipas objektivave të veprimtarisë së saj të përcaktuara në nenin 1.

NENI 7

Abuzimi i Ortakëve ndaj Shoqërisë

Ortakët e Shoqërisë, që kryejnë një ose më shumë nga aktivitetet ose papajtueshmëritë e mëposhtme, janë personalisht ose bashkërisht përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë, me të gjitha pasuritë e tyre nëse:

- a. abuzimi me formën e veprimtarisë tregtare për të arritur qëllime të kundërligjshme;
- b. trajtojnë asetet e Shoqërisë sikur të ishin të tyre;
- c. në momentin që ata kanë qenë ose duhet të ishin vënë në dijeni për paaftësinë e shoqërisë për të mbuluar detyrimet, të mos marrin masat e nevojshme për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitalin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet ndaj palëve të treta.

Shkelja e këtij neni jep arsye për përjashtimin e Ortakut sipas nenit 10 më poshtë dhe dispozitës përkatëse të ligjit tregtar shqiptar në fuqi.

NENI 8

Ndalimi i konkurrencës

Ortakët marrin përsipër për sa kohë që janë ortakë të shoqërisë në territorin e Republikës së Shqipërisë të mos angazhohen në asnjë nga veprimet e mëposhtme, drejtpërdrejt, tërthorazi, në emër të tyre ose të palëve të treta, në asnjë mënyrë:

- a. Kryerja e aktiviteteve në konkurrencë me veprimtarinë e TÛV AUSTRIA Albania SH.P.K. sipas nenit 1
- b. Fitojnë ose mbajnë një aksion në çdo person juridik që ushtron, zotëron ose kontrollon një person juridik që kryen aktivitete në konkurrencë me veprimtarinë tregtare të TÛV AUSTRIA Albania SH.P.K. sipas nenit 1

Pronarët përfitues të Ortakëve nuk mund të kenë një pozicion si drejtues ose të punësohen në ndonjë shoqëri tjetër që operon në të njëjtin sektor biznesi Republikën e Shqipërisë siç parashikohet në nenin 1 në. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të operuar në këtë sektor në Shqipëri.

Nga ky ndalim përjashtohet aktiviteti ekzistues që filiali i Ortakut të shumicës së Shoqërisë, përkatësisht shoqëria greke me përgjegjësi të kufizuar “TUV - AUSTRIA HELLAS SINGLE-MEMBER LIMITED LIABILITY COMPANY”, me seli në Bashkinë e Shën Paraskevisë/Atikë dhe numër i regjistrimit tregtar 001650201000 është krijuar tashmë në Shqipëri në formën e një dege.

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



Në të gjitha rastet e tjera, ndalimi i sipërpërmendur mund të revokohet me autorizim të veçantë të dhënë nga Asambleja e Përgjithshme me kuorumin prej 50% dhe shumicën prej 51% të votave.

Sa më sipër do të mbetet në fuqi për të paktën:

- a. periudhën e parashikuar në autorizimin e dhënë, ose
- b. periudhën e lejuar nga ligji shqiptar,

edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të Ortakut siç është referuar, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së cilësisë së përmendur.

Nëse njëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, Shoqëria mund të:

- a. Përfshijë Ortakun në fjalë nga Shoqëria;
- b. Të kërkojë ndërprerjen e aktivitetit konkurrues;
- c. Kërkojë dëmshpërblime.

Pavarësisht pretendimit të dëmeve, Shoqëria mund të kërkojë nga Ortakët:

- a. Të pranojë transaksionet e kryera në llogarinë e vet si transaksion të kryer në llogari të Shoqërisë;
- b. Të transferojë në shoqëri çdo përfitim që rezulton nga transaksionet e bëra në llogarinë e dikujt tjetër;
- c. Të transferojë në shoqëri çdo pretendim që rrjedh nga transaksionet e bëra në llogarinë e dikujt tjetër.

NENI 9

Largimi i Ortakut nga Shoqëria dhe likuidimi i kuotave

Një ortak mund të largohet nga shoqëria nëse Ortakët e tjerë ose shoqëria:

- ka kryer veprime në dëm të tij;
- nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij;
- nëse Shoqëria e ka ngarkuar atë me detyrime të paarsyeshme ose për shkaqe të tjera, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënies së Ortakut.

Ortaku që largohet nga Shoqëria duhet të informojë Shoqërinë me shkrim dhe të parashtrojë arsyet për këtë largim. Administratori/ët duhet të thërrasin një Asamble të Përgjithshme menjëherë pasi të jenë informuar për largimin, për të vendosur nëse kuotat e Ortakut duhet të likuidohen për shkak të largimit të tij për shkaqe të arsyeshme. Një ortak ka të drejtë të procedojë në gjykatë kundër shoqërisë për likuidimin e kuotave të tij, në bazë të largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit të tij Asambleja e Përgjithshme nuk është mbledhur ose nuk ka shqyrtuar shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotave si të arsyeshme.

NENI 10

Përfshijimi i Ortakut

Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me vendimin e marrë me shumicë të thjeshtë votash dhe kuorum prej 50%, mund t'i kërkojë gjykatës përfshijimin e Ortakut, nëse ai nuk ka dhënë kontributin e tij, ose nuk ka paguar kontributet si rezultat i financimit, investimeve, shtesat në kapital dhe detyrimet e tjera sipas këtij Statuti ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përfshijim.

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



Shkaqet e arsyeshme për përjashtimin e një Ortaku përfshijnë, pa kufizim, rastet në rast se Ortaku:

- me dashje ose nga pakujdesia e rëndë i shkakton dëm Shoqërisë ose Ortakëve të tjerë;
- me dashje ose nga pakujdesia e rëndë shkel këtë statut ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- është i përfshirë në aktivitete të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve ndërmjet Shoqërisë dhe Ortakut;
- me veprimet e tij shkakton dëme ose pengon në mënyrë thelbësore veprimtarinë tregtare të Shoqërisë;
- për arsytet e parashikuara sipas rastit në këtë Statut ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Gjatë procedurës së përjashtimit të një ortaku, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë masa të përkohshme për sigurimin e padisë, duke i pezulluar të drejtën e votës Ortakut që do të përjashtohet, si dhe të drejta të tjera që rrjedhin nga posedimi i kuotave të Shoqërisë, në rast se e gjykon të nevojshme dhe të justifikuar këtë masë. Shoqëria ka të drejtë të kërkojë nga ortaku i përjashtuar pagesën e dëmeve që rrjedhin nga aktivitetet që kanë shkaktuar përjashtimin. Një ortak ka të drejtë të kërkojë pagesën e dëmeve nga Shoqëria nëse kërkesa për përjashtim nuk ka bazë. Një ortak nuk ka të drejtë të kërkojë likuidimin e kuotave të tij, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por nëse Shoqëria vazhdon për pagesën e dëmeve, Ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që mund të përfitojë në cilësinë e tij të likuidimit të kuotave të tij, me dëmin e kërkuar nga Shoqëria.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 11

Veprimtaria e vazhdueshme e Shoqërisë bazohet në kërkesat e tregut të ekonomisë së hapur. Aktiviteti ekonomik ndërtohet mbi parimet e kontabilitetit dhe pasqyrohet në bilancet e tij.

NENI 12

Kapitali fillestar i paguar nga ortakët përbën bazën e fondit fillestar të mjeteve të qarkullimit. Administratori u dorëzon ortakëve dokumentin e verifikuar për shumat e parave të paguara në fazën fillestare. Vlerësimi i kapitalit në natyrë bëhet nga ortakët themelues në momentin e themelimit të shoqërisë ose pas regjistrimit në rast të zmadhimit të kapitalit.

NENI 13

Kapitali fillestar i shoqërisë bëhet nga kontributi i Ortakëve themelues të shoqërisë në para, në vlerën ALL (lek) 1,000,000 lekë dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota.

Kuotat e kapitalit fillestar të "TUV AUSTRIA Albania" Sh.p.k ndahen si më poshtë:

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



Ortakët	Nr. i kuotave	% kuotës së kapitalit	Kontributi monetar në ALL
TÜV AUSTRIA HOLDING AG	1	65%	ALL 650,000
Albanian Development Company ADC SH.P.K	1	35%	ALL 350,000
Totali	2	100%	ALL 1,000,000

Kapitali fillestar paguhet në total nga ortakët themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit është kryer nga Ortakët themelues.

NENI 14

Asetet e Shoqërisë

Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së paluajtshme kur vlera e aseteve mbulohet plotësisht me para cash.

NENI 15

Transferimi i kuotave

Kuotat dhe të drejtat që ato japin do të fitohen nëpërmjet:

- Pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të autorizuar në themelimin e Shoqërisë;
- Blerje;
- Trashëgimi;
- Dhurim;
- Mënyra të tjera të parashikuara me ligj.

NENI 16

Kufizimi në transferimin e kuotave

Ortakët e Shoqërisë kanë vendosur të themelojnë këtë Shoqëri duke marrë parasysh cilësitë që secili duhet t'i ofrojë Shoqërisë dhe çdo transferim i kuotave i bërë në kundërshtim me këtë nen, mund të sjellë prishjen e Shoqërisë. Duke marrë parasysh qëndrimin e mësipërm, transferimi i kuotave në Shoqëri është subjekt i kufizimeve të mëposhtme.

Pavarësisht nga mënyra e blerjes ose transferimit të kuotave, kërkohet miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Megjithatë, Palët bien dakord që Ortaku i shumicës rezervon të drejtën për të transferuar Kuotat e tij në çdo kohë pa miratim në Asamblesë së Përgjithshme për çdo shoqëri të lidhur brenda Grupit TÜV AUSTRIA. E drejta e parablerjes zbatohet në çdo rast tjetër të transferimit të kuotave. Ortaku që synon të transferojë Kuotat e tij ("Ortaku Shitës") duhet të njoftojë Shoqërinë, duke ofruar të gjitha informacionet në lidhje me transferimin e kuotave, duke përfshirë përqindjen (%) e kuotave që do të transferohen, çmimin e ofruar të blerjes, termat dhe kushtet e shitjes, dhe blerësin e mundshëm ("Informacioni i shitjes"), nëse Ortakët e tjerë ("Ortakët e mbetur") nuk do të zbatojnë të drejtën e refuzimit të parë. Shoqëria

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



do të njoftojë Ortakët e mbetur të cilët kanë të drejtë të shprehin interesin e tyre për blerjen e kuotave brenda 30 ditëve nga njoftimi i marrë nga Shoqëria. Nëse Ortakët e mbetur nuk i përgjigjen ofertës, atëherë ortaku shitës mund t'i transferojë Kuotat e tij blerësit potencial, sipas kushteve të paraqitura në Informacionin e Shitjes. Në çdo rast, ortaku i shumicës ka të drejtën e refuzimit të parë për çdo transferim të kuotave nga ortaku i pakicës dhe se çdo transferim i kuotave në shkelje të kësaj të drejte të refuzimit të parë është i pavlefshëm.

Ortaku i shumicës ka një opsion të thirrjes në lidhje me të gjitha Kuotat dhe të drejtat e votës në Shoqëri në rast se Ortaku i pakicës ndryshon strukturën e tij të ortakëve dhe ka një ndryshim të kuotave të tij të shumicës dhe/ose përfaqësuesve ligjorë. Në këtë rast transferimi i kuotave do të bëhet automatikisht duke miratuar në këtë statut dokumentin e transferimit të kuotave sipas Aneksit I. Çmimi i transferimit të kuotave në këtë rast do të jetë vlera kontabël e kuotës në momentin e transferimit të kuotave, sipas për dispozitën në fuqi të legjislacionit fiskal shqiptar.

Transferimi i kuotave nëpërmjet trashëgimisë, dhurimit ose formave të tjera të parashikuara me ligj i nënshtrohet miratimit të Ortakut tjetër dhe në rast se miratimi nuk jepet, atëherë trashëgimtarët, përfituesi i dhurimit ose çdo palë e tretë kanë të drejtën e likuidimit të vlerës së kuotës së transferuar tek ky subjekt. Likuidimi do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9 më sipër vetëm në vlerën e kapitalit themeltar. Në këtë rast transferimi të kuotave, përfituesi ka të drejtën e shpërndarjes së fitimit në masën e kuotave të zotëruara. Neni 22 i këtij Statuti nuk është i zbatueshëm në këtë rast.

NENI 17

Kuotat mund të anulohen në çdo kohë me miratimin e Ortakëve të interesuar. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga këto kuota fshihen me anulimin e tyre. Rastet e anulimit të kuotave do të përcaktohen me rregullore të veçanta, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën prej 75% të votave dhe kuorumin prej 50%. Likuidimi do të bëhet në bazë të nenit 9 të këtij Statuti.

NENI 18

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali fillestar mund të zmadhohet ose zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me vendim të marrë me shumicë 75% të votave dhe kuorum prej 50%. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet kur kërkohet nga interesat e Shoqërisë duke vendosur kuota shtesë me Ortakët. Mbledhja e Përgjithshme vendos për çdo zvogëlim të kapitalit të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët apo të krijojë paqartësi për ata që kanë dhënë kredi përpara shpalljes së zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërt gjykata me kërkesë të kreditorëve do ta konsiderojë këtë vendim të pavlefshëm.


NENI 19

Fondi rezervë

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



Shoqëria krijon një fond rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 20

Bilanci, plani financiar

Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në bilancin e saj në monedhën kombëtare dhe në euro sipas vlerësimit të ortakëve ose auditorëve, në momentin e themelimit të shoqërisë. Pasqyra vjetore financiare prezantohet deri më 31 mars të vitit të ardhshëm. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në përputhje me formularët e balanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë dhe përveç asaj në përputhje me standardin e raportimit të Grupit TÜV AUSTRIA. Planin financiar parashikon hyrjet dhe daljet e aktivitetit ekonomik në Shqipëri, të tërhequra në lekë dhe euro. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Këmbimi i monedhës shqiptare me valutën e huaj dhe anasjelltas do të bëhet në fund të çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar.

NENI 21

Fitimet e pashpërndara dhe shpërndarja e fitimit

Ortakët vendosin reciprokisht për proporcionin e fitimeve të pashpërndara dhe shpërndarjes së fitimeve në përputhje me gjendjen financiare dhe nevojat financiare të Shoqërisë duke marrë parasysh ekzistencën dhe rritjen e qëndrueshme të Shoqërisë.

21.1 Ortakët themelues vendosin që pjesa e fitimeve që u vendos të shpërndahet u shpërndahet ortakëve në mënyrë të barabartë (50% - pesëdhjetë për qind për secilin) për një periudhë të kufizuar, e cila është e specifikuar që nga themelimi i Shoqërisë deri në datën 31 Dhjetor 2029. Nga 1 janari 2030 e në vijim, ortakët themelues bien dakord që shpërndarja e fitimit të jetë në përputhje me pjesëmarrjen e kuotave të çdo Ortaku në kapitalin e Shoqërisë sipas nenit 13.

21.2 Objektivi financiar

Ortakët kanë rënë dakord në mënyrë të shprehur se targeti kumulativ/ kthimi total operativ i Shoqërisë për pesë (5) vitet e ardhshme deri më 31 dhjetor 2029, kështu që për periudhën kohore që fillon me realizimin e themelimit të Shoqërisë dhe përfundon më 31 dhjetor 2029 (në vijim referuar si "**Periudha Financiare**"), është vendosur bashkërisht në 12,000,000 € (dymbëdhjetë milionë euro) (pa TVSH), me një EBIT total gjatë Periudhës Financiare prej njëzet e pesë për qind (25%), pra një EBIT total në shumën prej 3,000,000 euro (tre milionë euro) (në vijim referuar si: "**Objektivi financiar**"). Sqarohet se objektivi financiar konsiderohet të jetë EBIT në terma absolut dhe jo të ardhurat.

21.3 Në rast të dështimit të Shoqërisë për të përmbushur objektivin financiar në fund të periudhës financiare dhe në varësi të përqindjes së devijimit nga objektivi financiar, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



- a. Devijimi negativ nga objektivi financiar nën ose i barabartë me 20%: nëse devijimi negativ nga objektivi financiar është i barabartë ose është nën njëzet për qind (20%), atëherë EBIT e Shoqërisë është midis 2,999,999 € dhe 2,400,000 €, Shoqëria do të vazhdojë të operohet nga Ortakët e saj në të njëjtën mënyrë sa i përket pjesëmarrjes së tyre në kapitalin dhe menaxhimin e Shoqërisë operuar deri në fund të Periudhës Financiare.
- b. Devijimi negativ nga objektivi financiar në intervalin 21% - 50%: nëse devijimi negativ nga objektivi financiar është në intervalin prej njëzet e një për qind (21%) deri në pesëdhjetë për qind (50%), kështu që EBIT e Shoqërisë është ndërmjet 2,399,999 € dhe 1,500,000 €, ortaku i shumicës do të ketë të drejtën të ushtrojë një opsion blerjeje për fitimin e pesëdhjetë për qind (50%) të përqindjes totale të pjesëmarrjes dhe të drejtës së votës në pronësi të Ortakut të pakicës. Është rënë dakord shprehimisht nga Ortakët që transferimi i kuotave brenda kuadrit të ushtrimit të opsionit të blerjes do të bëhet pa pagesën e një çmimi përkatës blerjeje, për shkak të investimeve, shpenzimeve dhe know-how që ka bërë Ortaku i shumicës ose parashikohet krijimi dhe funksionimi i Shoqërisë. Transferimi i kuotave përkatëse do të bëhet brenda 90 ditëve pas ushtrimit të opsionit të blerjes.
- c. Devijimi negativ nga objektivi financiar që tejkalon 50%: Nëse devijimi negativ nga objektivi financiar tejkalon pesëdhjetë për qind (50%), pra EBIT e Shoqërisë është nën 1,499,999 €, Ortaku i shumicës do të ketë të drejtën të ushtrojë një opsion blerjeje për njëqind për qind (100%) të totalit të pjesëmarrjes dhe të drejtave të votës në pronësi të Ortakut të pakicës. Është rënë dakord shprehimisht që transferimi i kuotave në kuadrin e ushtrimit të opsionit të blerjes do të bëhet pa pagesën e një çmimi përkatës blerjeje, për shkak të investimeve, shpenzimeve dhe know-how që Ortaku i shumicës ka bërë dhënë për themelimin dhe funksionimin e Shoqërisë. Transferimi i kuotave përkatëse do të bëhet brenda 90 ditëve pas ushtrimit të opsionit të blerjes.

NENI 22

Kufizimi i shpërndarjes së fitimit

Shoqëria mund të shpërndajë dividendët për Ortakët, vetëm nëse pas pagesës së dividendit:

- asetet e Shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e saj;
- Shoqëria ka aktive të mjaftueshme likuide për të paguar detyrimet që kërkojnë brenda 12 muajve të ardhshëm.

Administratori/ët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve plotëson kriteret e mësipërme. Në rast se situata e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendit nuk i plotëson këto kriteret, Administratori/at nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë. Administratori/ët përgjigjen/janë përgjegjës për shoqërinë për vlefshmërinë e certifikatës së aftësisë paguese. Administratori/ët, të cilët për shkak të pakujdesisë lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht ndaj Shoqërisë për rikuperimin e dividendëve të shpërndarë. Ortakët, të cilët kanë marrë dividendë nga Shoqëria, përgjigjen personalisht për shoqërinë për rikuperimin e dividendëve që janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë janë informuar për paaftësinë

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



paguese të Shoqërisë, përveç rasteve kur është e qartë nga rrethanat se ata nuk mund të kishin ditur për këtë situatë.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 23

Asambleja e Përgjithshme

Organi kryesor i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme (në vijim referuar si “**Asambleja e Përgjithshme**” ose “**Mbledhja e Përgjithshme**”).

Asambleja e Përgjithshme ka një kryetar të emëruar për të kryesuar të gjitha Mbledhjet e Përgjithshme. Kryetari mund t’ia delegojë funksionet e tij/saj një anëtar tjetër të Asamblesë së Përgjithshme nëse ai/ajo nuk mund të marrë pjesë në një Mbledhje të Përgjithshme. Kryetari i parë i shoqërisë emërohet z. Ioannis Kallias, shtetas grek, lindur në Athinë, më 7 mars 1973, madhor dhe zotësisë të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. AT1730678 (“**Kryetari**”). Mandati i Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme është për periudhë të pacaktuar dhe mund të zëvendësohet me vendim unanim të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime me 75% të votave (“**Shumica e Cilësuar**”) të Ortakëve në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e Statutit;
2. riorganizimi i Shoqërisë;
3. ndryshim në shpërndarjen e fitimeve;
4. raste të tjera të parashikuara me ligj ose me statut;
5. të ndryshojë shtetësinë e Shoqërisë;
6. rritja e detyrimeve të ortakëve;
7. zmadhimi i kapitalit themeltar (përveç rastit kur ky zmadhim i kapitalit themeltar bëhet ex lege ose kryhet nga kapitalizimi i rezervave);
8. zvogëlimi i kapitalit themeltar;
9. zmadhimi i kapitalit themeltar me kontribute në natyrë;
10. të hyjë në çdo transaksion që rezulton në një bashkim, ndarje, shndërrim ose ndonjë transaksion në të cilin të gjitha ose të gjitha asetet kryesore të Shoqërisë do të shiten ose do të licencohen ekskluzivisht për çdo transaksion;
11. likuidojë, shpërndajë ose mbyllë Shoqërinë;
12. shkurttojë ose zgjasë kohëzgjatjen e shoqërisë.

Në të gjitha rastet e tjera, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i detyrueshëm, Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë (me 50%) dhe kuorum prej 50%. Raste të tjera të tilla për shembull janë si më poshtë:

- përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve;
- emërimin ose shkarkimin e likuiduesve dhe auditorëve të certifikuar;
- përcaktimi i shpërblimeve për administratorin/ët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



- mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/ët, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve për ecurinë e aktivitetit;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të progresit ekonomik;
- përfaqësimi i Shoqërisë në gjykatë dhe në procese të tjera ndaj administratorit/ve;
- ndarja e kuotave dhe anulimi i tyre;
- miratimi i rregulloreve procedurale të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 24

Asambleja e Përgjithshme thirret sa herë që mbledhja (“Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme”) është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret veçanërisht nëse:

- a. sipas pasqyrave financiare vjetore ose raporteve financiare të ndërmjetme rezulton ose ekziston rreziku që asetet e Shoqërisë të mos mbulojnë kërkesat për pagesa të 3 muajve të ardhshëm;
- b. Shoqëria propozon të shesë ose transferojë asete, me një vlerë më të madhe se 5% të aktiveve të Shoqërisë bazuar në pasqyrën e fundit financiare të certifikuar;
- c. Shoqëria, brenda 2 ditëve pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një Ortak asete me vlerë më të madhe se 5% të aseteve të Shoqërisë bazuar në pasqyrën e fundit financiare të certifikuar.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori/ët ose Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë. Në rastet e parashikuara në pikën a. dhe c. më sipër i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme një raport i përgatitur nga një auditor i certifikuar dhe i pavarur. Në këto raste, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një vendim këshillimor, duke konfirmuar ose kundërshtuar veprimtarinë e administratorit.

NENI 25

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret me njoftim me shkrim ose me postë elektronike (e vlefshme vetëm nëse është marrë një konfirmim jo automatik i marrjes). Njoftimi me shkrim ose e-mail duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t’u dorëzohet ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së njoftuar për Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk thirret si më sipër, vendimet e vlefshme mund të merren vetëm nëse të gjithë Ortakët bien dakord për marrjen e vendimeve, pavarësisht nga parregullsitë.

NENI 26

Kuorumi i nevojshëm dhe vendimmarrja

Në rast të një vendimi që kërkon një shumicë të thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në prani të 50% të ortakëve me të drejtë vote. Në rast se Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për rastet që kërkojnë një shumicë të cilësuar, ajo

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse Ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e totalit të votave janë personalisht të pranishëm, me votim me shkrim ose elektronik. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet për mungesë të kuoromit të sipërpërmendur, Asambleja e Përgjithshme mblidhet sërish jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet e përmendura në nenin 23, pikat 1 deri në 12 dhe çështje të tjera që konsiderohen të rëndësishme për ekzistencën e shoqërisë. Në raste të tjera, sipas nenit 23, më poshtë pikave 1 deri në 12 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës. Ortakët, të cilët nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në Asamblesë të Përgjithshme me forma të ndryshme komunikimi, duke përfshirë edhe mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Ortaku, të cilit i ndalohet të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotave në shoqëri, ka të drejtë të kërkojë nga gjykata që të urdhërojë përfundimin e këtij kufizimi ose mund të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e kufizimit të këtyre të drejtave. Vendimet nënshkruhen në prani, me mjete elektronike ose duke qarkulluar sipas rregullave të brendshme të Shoqërisë.

NENI 27

Procesverbali i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori/ët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, rendin e ditës, emrin e mbajtësit të Asamblesë së Përgjithshme dhe rezultatet e votimit. Procesverbali duhet të ketë bashkëlidhur listën e pjesëmarrësve, si dhe njoftimin për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nënshkruhet nga Administratori.

NENI 28

Hetimet e posaçme dhe pavlefshmëria e vendimit të parregullt

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të fillojë një hetim të posaçëm për parregullsitë gjatë veprimtarisë së themelimit të shoqërisë ose veprimtarisë së veprimtarive tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur në këtë fushë. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të totalit të votave të Shoqërisë dhe/ose çdo kreditor i Shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme të caktojë një ekspert të pavarur të fushës, në rast se ka dyshime për shkelje të ligjit ose Statutit, në të kundërt, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga Asambleja e Përgjithshme për të caktuar një ekspert të pavarur, mund të paraqesin kërkesë në gjykatë për caktimin e këtij eksperti. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim brenda 60 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve konsiderohet e refuzuar. E drejta për të kërkuar një hetim të posaçëm duhet të ushtrohet brenda 3 viteve nga data e regjistrimit të Shoqërisë, në rast se objekt hetimi janë parregullsitë e procesit të themelimit, dhe brenda 3 viteve nga data që aktiviteti konsiderohet i parregullt në rast se janë nën hetim parregullsi në funksionimin e veprimtarisë tregtare. Në rast se një vendim i parregullt i administratorit/ve të shoqërisë miratohet në kundërshtim me ligjin, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të kërkojë

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



anulimin nga gjykata kompetente. Ortaku me të paktën 5% të totalit të votave të Shoqërisë ose çdo kreditor i Shoqërisë ka të drejtë të paraqesë një kërkesë në Asamblenë e Përgjithshme për të proceduar me anulimin si më sipër, ose mund të procedojë vetë para gjykatës brenda 30 ditë nga refuzimi i kërkesës së tyre nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk i përgjigjet kërkesës së përmendur brenda 60 ditëve, kërkesa konsiderohet e refuzuar. Procedurat para gjykatës ndiqen nga një përfaqësues i posaçëm i shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët ose Ortakët me të paktën 5% të kuotave kanë të drejtë të kërkojnë para gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit, nëse ka dyshime të arsyeshme për veprimet e përfaqësuesit. Në rastet e hetimit të posaçëm ose pavlefshmërisë së vendimit të parregullt zbatohen nenet 91 dhe 92 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 29

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë individë si Administratorë të Shoqërisë me shumicë të thjeshtë. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë riemërimi. Emërimi i administratorit/ve jep efekt pas regjistrimit në qendrën kombëtare të regjistrimit. Ky statut mund të përcaktojë rregulla të veçanta për emërimin e administratorit/ve. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë **z. Fatjon Sinani**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, në 25 maj 1982 madhor dhe me zotësisë të për të vepruar, mbajtës i ID me numër personal I20505087J

Shoqëria përfaqësohet, para çdo organi administrativ, personi juridik, ent publik ose privat dhe në lidhje me një palë të tretë nga administratori/ët që i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 30

Kompetencat e Administratorit

Administratori/ët ka/kanë të drejtë dhe janë të detyruar të:

1. kryen të gjitha veprimtaritë e administrimit të Shoqërisë, duke zbatuar politika tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
2. përfaqëson Shoqërinë;
3. kujdeset për mbajtjen e rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të Shoqërisë;
4. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e dividendëve, i paraqet këto dokumente për miratim para Asamblesë së Përgjithshme;
5. krijon një sistem paralajmërimi për rrethanat që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
6. kryen regjistrimet dhe dorëzon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në qendrën kombëtare të regjistrimit, sipas ligjit;
7. raporton para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të veçanta me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



8. kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj dhe statut.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një Administrator, ata administrojnë shoqërinë bashkërisht. Statuti i Shoqatës ose rregulloret e tjera, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të thjeshtë votash. Statuti i Shoqatës ose marrëveshjet e tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë. Procedurat, lidhur me shpërblimet e administratorit/ve, bazuar në marrëdhëniet kontraktore me Shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave në fuqi. Administratori/ët ka/kanë kufizime në kompetencat e tij/saj. Ai/ajo nuk ka të drejtë të lidhë kontrata për një shumë më të madhe se ekuivalenti në monedhën leke të 40,000 euro pa miratimin e nënshkrimit të dytë që mban Z. Charalampos Alexandros Spiliopoulos, shtetas grek, lindur më 14 mars 1973 në Mynih, madhor dhe me zotësisë të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. AY3290971. Nënshkrimi i dytë caktohet me vendim unanim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 31

Shpërblimet e Administratorëve

Shpërblimi normal i administratorit/ve mund të marrë shtesa, për shembull komponentë të bazuar në performancë. Shpërblimet e administratorit/ve mund të përcaktohen me vendim të zakonshëm me shumicë të thjeshtë dhe kuorum prej 50% të Asamblesë së Përgjithshme. Shpërblimi duhet të jetë në përputhje me detyrat e administratorit/ve dhe gjendjen financiare të Shoqërisë. Nëse Shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për uljen e shpërblimeve të administratorit/ve në masën e duhur. Kriteret e shpërblimit, shpërblimit individual dhe efekti vjetor i shpërblimeve të administratorit/ve në strukturën e kostove të Shoqërisë publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 32

Auditues të certifikuar

Shoqëria cakton auditorë të certifikuar për çdo vit financiar. Emërimi i tyre bëhet nga Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme. Auditorët e certifikuar mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata janë përgjegjës për dëmet e shoqërisë dhe mbajtjen e gabuar të llogarive ose verifikimin e gabuar të tyre. Ka konflikt interesi dhe nuk mund të ngarkohen me detyrën e auditorëve të certifikuar nëse janë ortakë, administrator/ë, persona të afërm të ortakëve ose administratorit/ve, zgjidhen të afërmit deri në nivelin e katërt.

VI. MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 33

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Statutit dhe legjislacionit shqiptar të punës. Punësimi në shoqëri kryhet nëpërmjet kontratës individuale të punës

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



ndërmjet Shoqërisë dhe punëmarrësve. Marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe sindikatës rregullohen me kontratë kolektive të punës.

NENI 34

Punëmarrësit, drejtuesit dhe punëmarrësit administrativë janë përgjegjës për dëmet që i janë shkaktuar Shoqërisë për fajin e tyre dhe për këtë përgjigjen civilisht.

VI. SHPËRRIJA E SHOQËRISË DHE LIKUIDIMI

NENI 35

Kjo shoqëri do të shpërndahet në rast të:

1. skadimit të periudhës për të cilën është themeluar;
2. të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme;
3. hapjes së procedurave të falimentimit;
4. nëse nuk ka kryer aktivitet tregtar për dy vjet dhe nuk ka njoftuar pezullimin e veprimtarisë në përputhje me nenin 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
5. vendimit të gjykatës;
6. të arsyeve të tjera të parashikuara në Statutin;

Shpërbërja e Shoqërisë regjistrohet në regjistrin tregtar nga qendra kombëtare e regjistrimit me raportin përkatës të administratorit/ve. Në rast shpërbërjeje me vendim gjykatë, gjykata ia transmeton vendimin qendrës kombëtare të regjistrimit për regjistrim në përputhje me nenin. 45 të ligjit nr.9723 për qendrën kombëtare të regjistrimit.

NENI 36


Likuidimi i Shoqërisë

Shpërndarja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi. Në rastin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, likuidimi bëhet nga likuidatori/ët i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim për emërimin e likuidatorit/ve, brenda 30 ditëve nga shpërbërja, çdo person i interesuar mund të kërkojë nga gjykata caktimin e një likuidatori. Çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë nga gjykata zëvendësimin e likuidatorit të caktuar me vendim të ortakëve, nëse paraqesin arsye të konsiderueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të kërcënohet nga likuidatori i caktuar. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuidatorit. Gjykata cakton likuidatorin, në rastet kur shoqëria shpërndahet me vendim gjykatë. Likuidatori/ët shkarkohen dhe zëvendësohen në të njëjtat kushte të parashikuara në dispozitat e emërimit të tij/tyre. Administratori/ët e Shoqërisë njofton/jnë për regjistrim, qendrën kombëtare të regjistrimit, të dhënat e likuidatorit/ëve të parë dhe të drejtat e tij/të tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



Likuidatori/ët depozitojnë nënshkrimin e tij/saj. Likuidatori njofton gjithashtu qendrën kombëtare të regjistrimit për çdo ndryshim të identitetit dhe të drejtave të përfaqësimit. Emërimi i likuidatorit nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i Shoqërisë pasohet nga shënimi “në likuidim”. Likuidatori/ët duhet të ftojnë kreditorët e Shoqërisë që të paraqesin pretendimet e tyre në lidhje me shpërbërjen e Shoqërisë. Likuidatori merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit/ve që nga data e emërimit të tij/saj.

NENI 37

Të drejtat dhe detyrimet e likuidatorit

Detyra e likuidatorit është mbyllja e të gjitha veprimtarive të Shoqërisë, mbledhja e të gjitha huave dhe kontributeve të papaguara, shitja e aktiveve të shoqërisë dhe pagesa e kreditorëve në përputhje me radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuidatori mund të kryejë veprimtari të tjera të reja tregtare për të mbyllur një veprimtari të papërfunduar. Nëse, në bazë të procedimeve të kreditorëve, likuidatori/ët konstatojnë se aktivet e veprimtarisë tregtare, përfshirë edhe kontributet e papaguara, nuk mjaftojnë për pagesën e këtyre pretendimeve, likuidatori/ët detyrohen të pezullojnë procedurën e likuidimit dhe të kërkojë nga gjykata fillimin e procedurave të falimentimit.

NENI 38

Bilancet e likuidimit

Likuidatori përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në momentin e fillimit të likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në momentin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuidatori përgatit, gjithashtu, pasqyrën financiare vjetore të shoqërisë në fund të vitit të punës pas fillimit të likuidimit. Pasqyrat financiare miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 39

Shpërndarja e asetëve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuidatori u shpërndan ortakëve asetet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në shpërndarjen e fitimeve, duke përjashtuar rastet kur jepen preferenca nga Statuti. Prona e dhënë ose e përdorur nga Shoqëria do t'u kthehet Ortakëve në fjalë. Pasi të jenë shpërndarë aktivet e mbetura, likuidatori duhet të njoftojë përfundimin e likuidimit në qendrën kombëtare të regjistrimit dhe të kërkojë çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me seksionin V të ligjit nr. 9723 për qendrën kombëtare të regjistrimit.

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



NENI 40

Likuidim i thjeshtuar

Shoqëria mund të likuidohet me procedurë të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga Ortakët dhe kur ata deklarojnë para gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve janë shlyer dhe të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit janë rregulluar. Administratori/ët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, shpallin për regjistrim në qendrën kombëtare të regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë nëpërmjet një procedure të thjeshtuar. Administratori/ët është/janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tij/saj gjatë procedurës së thjeshtuar. Përveç administratorit/ve, Ortakët janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës deri në shumat e kompensimit të rikuperuar.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 41

Ky statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar nga qendra kombëtare e regjistrimit.

NENI 42

Çdo gjë që nuk parashikohet shprehimisht në këtë statut do t'i nënshtrohet legjislacionit tregtar dhe ligjeve të tjera që lidhen me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 43

Ky Statut u lexua dhe u vendos bashkërisht nga Ortakët themelues dhe u gjet pa asnjë kundërshtim. Statuti u përgatit në tre kopje në gjuhën Angleze dhe u përkthye në gjuhën shqipe nga përkthyesi zj. Eva Xhani, i pranuar nga Ortakët e shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Për dhe në emër të Ortakut Albanian Development Company ADC SH.P.K:

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

Emri: Eneid Lika

Pozicioni: Administrator

Për dhe në emër të Ortakut TÜV AUSTRIA HOLDING AG:

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

Emri: DI Dr. Stefan Haas

Pozicioni: Drejtor Ekzekutiv

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

Emri: Mag. Christoph Wenninger

Pozicioni: Drejtor Finance



(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



KONTRATE SHIT - BLERJE KUOTASH
("Kontrata")

Sot më datë ____ / ____ / ____, lidhet kjo kontratë ndërmjet palëve me kushtet dhe termat e mëposhtme:

SHITËSI:

"Albanian Development Company ADC SH.P.K", regjistruar dhe që zhvillon veprimtarinë sipas ligjeve shqiptare në fuqi, me seli të regjistruar në Rr. "Rezervat e Shtetit", Lunder 1, Zona Kadastrale Nr. 2529, Pasuria nr. 590/1/4, Volume 6, Faqja 106, Lunder, Farkë, Tiranë, Shqipëri, identifikuar me nr. NIPT L52104227K, e përfaqësuar në nënshkrimin e kësaj kontrate nga administratori i saj

DHE

BLERESI

- **TÜV AUSTRIA HOLDING AG**, person juridik austriak që vepron sipas ligjeve të Austrisë, me seli të regjistruar në zyrat e Deutschstraße 10, 1230 Vienna, Austria, regjistruar në Regjistrin Tregtar me nr. FN 286107x, përfaqësuar nga administrator dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë

Shitësi dhe blerësi do t'ju referohemi kur janë sëbashku me termin "**Palët**" dhe individualisht si "**Palë**".

Palët kanë rënë dakord për lidhjen e kësaj kontrate për shit-blerjen e kuotës, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME:

SHARE TRANSFER AGREEMENT
(the "Contract")

Today, on ____ / ____ / ____, between the Parties, with the following terms and conditions:

THE SELLER:

"Albanian Development Company ADC SH.P.K", duly established and operating under the laws of Albania, with registered offices in Strët "Rezervat e Shtetit", Lunder 1, Cadastral Zone Nr. 2529, Property nr. 590/1/4, Volume 6, Page 106, Lunder, Farke, Tirana, Albania with unique identification number of the subject L52104227K, duly represented at the signing of this agreement by its administrator (hereinafter referred to the "**Seller**")

AND

THE BUYER:

- **TÜV AUSTRIA HOLDING AG**, an Austrian legal entity duly established and operating under the laws of Austria, with registered offices in Deutschstraße 10, 1230 Vienna, Austria, registered with the commercial registry under number FN 286107x, duly represented by its legal representative (hereinafter referred to the "**Buyer**")

the Seller and the Buyer collectively referred to as the "**Parties**" and individually the "**Party**".

The Parties have agreed to conclude this Contract for share transfer, under the laws of Albania.

GENERAL PROVISIONS:

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



Shitësi në këtë kontratë është ortak i TUV AUSTRIA Albania SH.P.K. (këtu e më poshtë do të përmendet me emrin “Shoqëria”), një shoqëri e krijuar sipas ligjeve shqiptare, regjistruar ne Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Shitësi është posedues i një kuote të kapitalit të Shoqërisë TUV Albania, sipas përqindjes së reflektuar në ekstraktin e shoqërisë. Blerësi, ortak në shoqëri, nëpërmjet kësaj kontrate dëshiron të blejë kuotën e shitësit me qëllim që të bëhet pronar ne masën prej ____ të kapitalit të Shoqërisë me të gjithë të drejtat dhe detyrimet q rrjedhin nga pronësia e kuotës. Neni 1 OBJEKTI I KONTRATES Objekti i kësaj kontrate është transferimi nga shitësi tek blerësi i kuotës së zotëruar në shoqëri. NENI 2 ÇMIMI I TRANSFERIMIT TË KUOTAVE DHE PAGESA Blerësi në mënyrë të paravokueshme bie dakord dhe deklaron të kryejnë pagesën sipas pikës 2 të këtij neni, e cila përfaqëson çmimin e transferimit të masës prej ____ % të kapitalit të shoqërisë të përbërë nga një kuotë sipas parashikimeve të kësaj kontrate. Çmimi i shitblerjes është paguar nga blerësi sipas mandatit bashkëlidhur dhe shitësi nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje me të sot dhe në të ardhmen. NENI 3 TRANSFERIMI I PRONËSISË	The Seller in this Contract is shareholder of the Company TÜV AUSTRIA Albania SH.P.K. (hereinafter referred to as the “Company”), a company duly incorporated under the Albanian laws, registered within the commercial register of the National Center of Registration. The Seller is the owner and possessor of one share of the capital of the Company, holding the percentage as provided in the extract of the Company. The Buyer also shareholder of the Company, through this Contract wishes to purchase the Seller's share in order to become the owner of ____% of the capital of the Company with all the rights and obligations stemming from the ownership of the quote. ARTICLE 1 SUBJECT MATTER OF THE CONTRACT The object of this Contract is the transfer from the Seller to the Buyer of share owned in the capital of the Company. ARTICLE 2 THE PRICE OF THE SHARE TRANSFER AND THE PAYMENT The Buyer hereby and irrevocably agrees and declares to make the payment according point 2 of this article, which represents the transfer price of ____% of the Company’s capital consisting of one share as described in this Contract. The purchase price is paid from the Buyer to the Seller and the Seller shall have no claim today or in the future. ARTICLE 3 THE TRANSFER OF THE PROPERTY
---	---

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pagimit të plotë të çmimit në përputhje me nenin 3 të saj, kapitali themeltar i shoqërisë do të zotërohet në masën ____% nga blerësi.

**NENI 4
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj kontrate, teksti në gjuhën shqipe do të ketë prioritet.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje identike në shqip dhe anglisht, ku secila nga palët mban një kopje, një kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar, një kopje do të depozitohet në Aktet e Shoqërisë.

Kjo kontratë ju bë e njohur në gjuhën angleze palëve, të cilat e nënshkruan në variantin anglisht prej përkthyeses Znj. Eva Xhani, e njohur personalisht dhe pranuar prej palëve.

PALËT

SHITËSI:

BLERËSI

After the signing of this Contract, the registered capital of the company shall be owned by ____% of the capital by the Buyer.

**ARTICLE 4
FINAL PROVISIONS**

This Contract is compiled both in English and Albanian language. In case of controversial interpretation or application, the text in Albanian shall prevail.

This Contract is compiled in 4 (four) identical copies both in English and Albanian, whereof each Party keeps one, one copy will be deposited in the Commercial Register, one copy will be deposited in the Company's Acts.

This Contract was translated in English language for acknowledgement by the Parties from the translator Ms. Eva Xhani personally known and accepted by the Parties in this Contract.

THE PARTIES

THE SELLER:

THE BUYER:

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ELVINA T. HAXHIAJ**

**DATE 21/03/2025
NR REP 437**



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 21/03/2024, para meje Notere ELVINA T. HAXHIAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, BLV"BAJRAM CURRI", NR.114, NR.23, NR.6, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Eva Xhani, atësia Skënder, amësia Merushe, shtetase Shqiptare, lindur në Gramsh dhe banues në Tiranë, me adresë S.Cico; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 01/09/1987, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035633413 dhe nr. personal I75901055R , .

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur Statut TUV Austria Albania, nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"," në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ELVINA T. HAXHIAJ

